

VENDIM
Nr. 451, datë 29.6.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 256, DATË 25.3.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KOMPENSIMIN PËR PRIVACIONET DHE HUMBJET, QË I SHKAKTOHEN PUNONJËSIT TË POLICISË SË SHTETIT, PËR SHKAK TË NEVOJAVE TË PUNËS DHE TË SHËRBIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, shkronjat “b” e “ç”, e 2, të nenit 67, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

- I. Në vendimin nr. 256, datë 25.3.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, kur emërohet, transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme jashtë vendbanimit të tij, përfiton pagesë për kompensim udhëtimi, si më poshtë vijon:
 - a) Nga 36 km deri 60 km, në masën 10 000 lekë në muaj;
 - b) Nga 61 km deri 100 km, në masën 15 000 lekë në muaj;
 - c) Nga 101 km deri 150 km, në masën 20 000 lekë në muaj;
 - ç) Nga 150 km deri 200 km, në masën 25 000 lekë në muaj;
 - d) Mbi 200 km, në masën 30 000 lekë në muaj.”.
 2. Kudo në tekstin e vendimit, fjala “... transferuar ...” zëvendësohet me fjalët “... emërohet, transferohet në mënyrë të përhershme apo të përkohshme ...”.
 3. Pika 13 shfuqizohet.
- II. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 korrik 2022.
- III. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj